

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pyetje të thjeshta që zbulojnë menjëherë një gënjeshtër – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/pyetje-te-thjeshta-qe-zbulojne-menjehere-nje-genjeshter/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 19:24:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 19:22:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a7d44660476ea98c439c9256f26056334d34bffe2a5c23f86572547d3fe17ca5
TEKSTI	ae78b6ac1ddc2371e9cdbdc2337a10895d5657aa2935db3089a724b0871471dc
PAMJA	f00a1e0756f41cf38eca2f87ac2df5ee33da245950db0214b0d2af04f371b8e6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	81db0a71065fc5b3dbb26ac4e3d9fb582148b7bd561c83c6f4b4f319d9a936b8
E MËPARSHMJA	649fde6e38ab5394e164a4b0c385ee934b44f39fa749a2d9fc5d23be459d4e41
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/81db0a71065fc5b3dbb26ac4e3d9fb582148b7bd561c83c6f4b4f319d9a936b8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Sipas psikologes Dr. Sharon Leal, eksperte e zbulimit të mashtrimit në Universitetin e Portsmouth, personi që gënjen përballet me një ngarkesë të lartë njohëse: duhet të mbajë mend historinë që ka treguar, të shmangë kontradiktat, të vëzhgojë reagimet e bashkëbiseduesit dhe njëkohësisht të kontrollojë sjelljen e tij.

Megjithatë, kjo ngarkesë nuk shfaqet domosdoshmërisht përmes lëvizjeve nervoze. Gënjeshtarët mund të qëndrojnë edhe më të palëvizshëm, pikërisht sepse përpiqen të kontrollojnë sjelljen e tyre.

Pyetjet që mund ta vështirësojnë gënjeshtren

Një nga teknikat më të dobishme është t'i kërkohet personit të tregojë disa herë të njëjtën ngjarje. Personat që thonë të vërtetën mund të kujtojnë detaje të reja gjatë rrëfimeve të përsëritura, ndërsa dikush që ka sajuar një histori ka më shumë gjasa ta mbajë atë të thjeshtë për të shmangur kontradiktat.

Një tjetër teknikë është kërkesa për të treguar ngjarjen në rend të kundërt, duke filluar nga fundi. Kjo rrit ngarkesën mendore, pasi një personi që ka përjetuar realisht ngjarjen i duhet vetëm të rikthehet te kujtesa, ndërsa ai që ka sajuar historinë duhet ta rindërtojë atë.

Po ashtu, pyetjet e papritura dhe të lidhura me detaje konkrete mund të jenë të dobishme. Për shembull, në vend të një pyetjeje të përgjithshme si "Ku ishte?", mund të kërkojnë detaje rreth ambientit, personave të pranishëm apo elementeve që mund të verifikohen.

5 Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor!
Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Provat dhe kontradiktat

Një tjetër qasje është përdorimi strategjik i provave. Personi që bën pyetjet mund të ketë tashmë informacion për atë që ka ndodhur, por të mos e zbulojë menjëherë.

Fillimisht i kërkohet tjetrit të tregojë versionin e tij. Më pas, kur paraqiten provat, vërehen kontradiktat mes asaj që është thënë fillimisht dhe fakteve të njohura.

Edhe heshtja mund të fshehë një gënjeshtër

Studiuesit kanë shqyrtuar edhe “gënjeshttrat përmes heshtjes” – raste kur një person thotë diçka të vërtetë, por fsheh qëllimisht një informacion të rëndësishëm.

Për shembull, dikush mund të thotë se “ishte në shtëpinë e një shoku”, duke mos përmendur se u largua për 20 minuta dhe më pas u kthye.

Edhe në këto raste, shenjat që mund të ngrenë dyshime janë kryesisht verbale: përgjigje të paqarta, shmangie e detajeve, përgjigje evazive dhe kontradikta që shfaqen kur bëhen pyetje të mëtejshme.

Përfundimi: nuk ekziston një gjest i vetëm që mund të provojë se dikush po gënjen. Në vend që të mbështetemi te kontakti me sy apo lëvizjet nervoze, është shumë më e dobishme të dëgjojmë me kujdes përgjigjet, të kërkojmë detaje dhe të kontrollojmë nëse rrëfimi qëndron i njëjtë përballë pyetjeve të ndryshme.

#genjeshter

#pyetje

#VizionPlus



Taulant Halili

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh




LIFESTYLE

Kush janë shenjat më besnike dhe më...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
21:32



LIFESTYLE

"Një surprizë mund t'ju ndryshojë..."

Xhuljana
Zhuleku

Dje
10:32



LIFESTYLE

Pse gërhitja e partnerit mund të...

Taulant Halili · 12 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.